**SKEMA E VLERËSIMIT TË TESTIT TË PROVIMIT PROFESIONAL NGA GJUHA SHQIPE DHE LETËRSIA, QERSHOR 2019**

**1.** Nxënësi/ nxënësja* merr ***1 pikë*** nëse ka shkruar: Në vitin shkollor 2014-15

**2.** Është rrethuar numri 3: Klasa IV C – ***1 pikë***

**3.** Nxënësi merr ***1 pikë*** nëse ka shkruar: Metoda e analizës, vëzhgimit dhe historisë jetësore

**4.** Nxënësi merr ***1 pikë*** nëse ka shkruar: Me gjuhën amtare/ gjuhën shqipe

**5.** Nxënësi merr ***1 pikë*** nëse rrethon S dhe shkruan argumentimin: Sepse ai më së miri i shpreh ndjenjat dhe shqetësimet e botës shqiptare.

**6.** Nxënësi merr ***1 pikë*** për përgjigje plotësisht të saktë:

| | | |
|---|---|---|
| Shfaqja dramatike *Glembajët* është luajtur në Galerinë e Arteve të Dubrovnikut. | PO (rrethuar) | JO |
| Teksti është botuar në orën 20 e 6 minuta. | PO | JO (rrethuar) |
| Tre akte të shfaqjes *Glembajët* janë luajtur gati katër orë. | PO (rrethuar) | JO |

**7.** Është rrethuar numri 2: Zllatko Sviben – ***1 pikë***

**8.** Nxënësi merr ***1 pikë*** nëse shkruan ose perifrazon: Skena është shumë kërkuese./ Skena teknikisht është kërkuese dhe nuk do të mund t'i përshtatet shpejt Budvës. *(dhe përgjigje të tjera të sakta)*

**9.** Është rrethuar numri 3: gazetaro-publicistik – ***1 pikë***

**10.** Nxënësi merr ***1 pikë*** nëse shkruan: Është vështirë të arrihen sukseset e shumë aktorëve të cilët kanë luajtur rolin e Leones. /Rolin e Leones e kanë luajtur shkëlqyeshëm shumë aktor dhe për këtë arsye e ka pasur të vështirë ta luaj atë rol. *(dhe përgjigje të tjera të sakta)*

**11.** A) Është rrethuar numri 3: Ismena – ***1 pikë***

B) Nxënësi merr ***1 pikë*** nëse shkruan: Vetëm Ismena është nga vepra *Antigona*, kurse të tjerët janë nga *Iliada*./ Ismena është një personazhe nga tragjedia, kurse të tjerët nga epi./ Të gjithë personazhet janë nga vepra e Homerit, përveç Ismenës e cila është nga vepra e Sofokliut. *(dhe përgjigje të tjera të sakta)*

***Vërejtje:*** Nuk pranohet përgjigjja e paplotë, p.sh. Vetëm Ismena është personazhe nga tragjedia Antigona.

---

*Në tekstin e mëtejshëm nxënësi

**12.** A) Nxënësi merr ***1 pikë*** për përgjigje plotësisht të saktë:

1. *Albatrosi* – Sharl Bodler
2. *Rrugnaja në mars* – Martin Camaj
3. *Xha Gorio* – Honore de Balzak
4. *Kurora e maleve* – Petar Petroviq Njegosh

B) Nxënësi merr ***1 pikë*** nëse ka shkruar: Xha Gorio/ Vepra nën numrin 3.

**13.** Gjithsej ***3 pikë*** – nxënësi merr nga *1 pikë* nëse pranë çdo citatit nga vepra shkruan saktë emrat e personazheve për të cilët flitet, përkatësisht sjelljet e të cilëve janë përshkruar:

Kleanti/ Herpagoni (***1 pikë***)

Kalina/ Emira (***1 pikë***)

Dr. Gjilpëra/ doganieri (***1 pikë***)

**14.** A) Nxënësi merr ***1 pikë*** nëse ka shkruar: Miguel Servantes

B) Nxënësi merr ***1 pikë*** nëse ka shkruar: Për një zënkë

**15.** Gjithsej ***2 pikë*** - nxënësi merr *2 pikë* nëse tregon karakterin e marrë dhe largpamës të Don Kishotit në këtë vepër. *(dhe përgjigje të tjera të sakta)*

Nxënësi merr *1 pikë* nëse tregon një tipar të personazhit.

**16.** Gjithsej ***2 pikë*** - nxënësi merr nga *1 pikë* nëse shkruan saktë titullin e veprës dhe gjininë letrare të cilës i përket vepre:

**Hilush Vilza** - “*Tregtar Flamujsh”,* novelë/ tregim/ epikë - ***1 pikë***

**Afërdita** - “*Nga jeta në jetë: PSE?!”,* roman/ prozë - ***1 pikë***

**17.** Nxënësi merr ***1 pikë*** për përgjigje plotësisht të saktë:

*Libri i Këngëve*

*Këngët e Milosaos*

**18.** Është rrethuar numri *4. në kohën e ardhme të shkuarës, mënyra dëftore* – ***1 pikë***

**19.** Nxënësi merr ***1 pikë*** për përgjigje plotësisht të saktë:

| GJERMANIKE VERILINDORE | SANSKRITISHTE | SLLAVE PERËNDIMORE |
|---|---|---|
| *suedeze*<br>*norvegjeze* | *hindi*<br>*bengale* | *polake*<br>*çeke*<br>*sllovake* |

**20.** Nxënësi merr ***1 pikë*** për përgjigje plotësisht të saktë: *Kënga lamtumirëse / Xhorxh Bajron*

**21.** Nxënësi merr ***1 pikë*** nëse ka shkruar: Motivi i largimit të heroit nga atdheu është zhgënjimi, pakënaqësia, deziluzioni

**22.** A) Nxënësi merr ***1 pikë*** nëse ka shkruar: Kemi përmbysje poetike.

B) Nxënësi merr ***1 pikë*** nëse ka shkruar: Fitohet figura stilistike e Inversionit

**23.** Nxënësi merr ***1 pikë*** nëse ka shkruar: të bleruara

**24.** Nxënësi merr ***1 pikë*** nëse ka shkruar: Austro - Hungarisë

**25.** Gjithsej ***2 pikë*** – Nxënësi merr ***1 pikë*** nëse shkruan: Gjatë sundimit turk familja e tij ka qenë rojë e urës, aty është rritur, ka jetuar, dhe tani gjithë ajo po zhduket. *(dhe përgjigje të tjera të sakta)*

*Për përgjigje me stil **2 pikë.***

**26.** Gjithsej ***2 pikë*** – Nxënësi merr ***1 pikë*** nëse shkruan: Ura. Të gjitha ngjarjet, në një periudhë kohore të gjatë zhvillohen në të njëjtën hapësirë ose rreth saj – urës/ Ura është vend i prerjes së hapësirës dhe kohës në roman, të gjitha gjërat me rëndësi ndodhin mbi të. *(dhe përgjigje të tjera të sakta)*

*Për përgjigje me stil **2 pikë.***

**27.** Gjithsej ***2 pikë*** – Nxënësi merr ***1 pikë*** nëse shkruan: Për shkak të strukturës së kompozicionit të tij. / Në te përshkruhen ngjarjet historike, shoqërore, familjare dhe përcillet rrjedha e tyre. *(dhe përgjigje të tjera të sakta)*

*Për përgjigje me stil **2 pikë.***

**28.** A) Nxënësi merr ***1 pikë*** nëse ka shkruar: vuajnë shumë *(dhe përgjigje të tjera të sakta)*

B) Nxënësi merr ***1 pikë*** nëse ka shkruar: Kundrinë

**29.** A) Është rrethuar numri 4: e ndritëshme – ***1 pikë***

B) Nxënësi merr ***1 pikë*** nëse ka shkruar: Trajtë e shkurtër e përemrit vetor

**30. Skema për vlerësimin e tekstit funksional**

| **Përmbajtja** | **Saktësia gjuhësore** | **Lidhshmëria** | **Forma grafike e tekstit** |
|---|---|---|---|
| Nxënësi merr **4 pikë** nëse me stil dhe saktë ka shkruar **njoftimin publik** i cili përmban të gjitha të dhënat e duhura:<br>- kush njofton<br>- kujt i kushtohet njoftimi<br>- tema e njoftimit<br>- kush do të flasë në përurimin e librit<br>- kush është moderator i mbrëmjes<br>- kurë do të zhvillohet përurimi<br>- ku do të zhvillohet<br><br>Nxënësi merr **3 pikë** nëse me stil dhe saktë ka shkruar **njoftimin publik** por ka lënë anash pa përdorur një të dhënë:<br>- kush njofton ose<br>- kujt i kushtohet njoftimi | Respektimi i normës gramatikore (përdorimi i drejtë i rasave, shkrimi i saktë i formave foljore, kongruencës, përdorimi i gjuhës standarde).<br><br>**2 pikë**<br>Respektimi i normës drejtshkrimore (shkrimi i drejtë i shkronjës së madhe, përdorimi i drejtë i shenjave të pikësimit, respektimi i rregullave të shkrimit të fjalëve bashkë dhe ndaras, zbatimi i njohurive për alternimin e zanoreve përdorimi i drejtë i zanores ***ë***).<br><br>**2 pikë**<br><br>**Gjithsej 4 pikë** | Lidhshmëria e mirë në nivel të tekstit.<br><br>**1 pikë** | Përshtatja e organizimit të përgjithshëm dhe i formës grafike të tekstit, strukturës logjike të tij (shpërndarja logjike e të dhënave: kush njofton në fillim të njoftimit, p.sh. Shoqata Kulturore "Iliria" njofton të gjithë qytetarët e interesuar .., ose: teksti i njoftimit me të gjitha të dhënat e nevojshme dhe kush njofton në fund...)<br>**1 pikë** |
| Nxënësi merr **2 pikë** nëse ka shkruar njoftimin, por ka lënë anash pa përdorur dy të dhëna të cilat nuk ndikojnë në kuptimin e njoftimit (kush njofton dhe kujt i kushtohet njoftimi) | Respektimi i normës gramatikore me gabime të vogla (p.sh. gabimet që kanë të bëjnë me përdorimin semantik të parafjalëve ***për*** dhe | | |

| **Përmbajtja** | **Saktësia gjuhësore** | **Lidhshmëria** | **Forma grafike e tekstit** |
|---|---|---|---|
| Nxënësi merr **1 pikë** nëse ka shkruar njoftimin i cili nuk i ka të gjitha të dhënat e nevojshme (kush njofton dhe/ose kujt i kushtohet njoftimi dhe/ose kush do të flasë në përurimin e librit dhe/ose kush është moderator i mbrëmjes), por është i lidhur me temën dhe është e qartë ku dhe kur do të mbahet përurimi i librit. | ***mbi****,* përemrit ***i vet/ i tij*****,** përdorimi i drejtë i ndërtimeve të tipit ***lidhur me këtë, duke marrë parasysh*** dhe i përemrave: ***që, i cili, e cila, të cilët*** etj.).<br><br>**1 pikë** | | |
| Nxënësi merr **0 pikë** nëse ka shkruar një njoftim i cili nuk ka lidhje me temën e dhënë, por ka shkruar një tekst i cili nuk është njoftim, ose ka shkruar ku dhe kur do të zhvillohet ngjarja... | Respektimi i normës drejtshkrimore me gabime të pakta ( p.sh. ndonjë mospërdorim i drejtë i shenjave të pikësimit, mosrespektimi i rregullave të shkrimit të fjalëve bashkë dhe ndaras, mospërdorimi i drejtë i zanores ***ë***).<br><br>**1 pikë**<br><br>**Gjithsej 2 pikë** | | |